

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 400 Kol.
Nr. 62 Rep.



**KONTRATË
SHIT – BLERJE KUOTASH**

Sot, më datë 19.01.05, para meje Agim Robo, Noter i Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht, Shitësi dhe Blerësit, të cilët më kërkuan redaktimin e kësaj Kontrate Shit – Blerje Kuotash me termat e mëposhtme :

SHITËSI: Z. Vito Loparco, shtetas italian, i datëlindjes 22 Qershori 1961, lindur në Cisternino, banues në Montalbano di Fisano në Brindisi (IT), person madhor më zotësi të plotë për të vepruar, me identitetin e të cilit u njoha nëpërmjet pasaportës me nr. 870121 X, lëshuar më datë 10.06.2003, ortak i Shoqërisë “BERAT konfeks” Sh.p.k., në të cilën zotëron 50% të kapitalit themeltar.

BLERËSIT: Z. Maksim Çuedari, shtetas shqiptar, i datëlindjes 27 Dhjetor 1958, i lindur në Pogradec dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me identitetin e të cilit u njoha nëpërmjet pasaportës me nr. 1562344, ortak i Shoqërisë “BERAT konfeks” Sh.p.k., në të cilën zotëron 25% të kapitalit themeltar.

Znj. Esmeralda Qirko, shtetase shqiptare, e datëlindjes 26 Korrik 1963, lindur dhe banuese në Berat, mahore me zotësi të plotë për të vepruar, me identitetin e të cilës u njoha nëpërmjet pasaportës me nr. 1562343, ortake e Shoqërisë “BERAT konfeks” Sh.p.k., në të cilën zotëron 25% të kapitalit themeltar.

OBJEKTI: Shitia e kuotave të shoqërisë “BERAT konfeks” sh.p.k. nga shitësi në masën 50% të kuotave që zotëron në kapitalin themeltar të Shoqërisë dhe blerjen e tyre nga Blerësit.

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Shoqëria Tregtare “BERAT konfeks” sh.p.k. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin Nr. 29221, datë 06.03.2003. Shoqëria ka një kapital themeltar të regjistruar prej 100.000 (njëqind mijë) lekë, të zotëruara nga ortakët në këtë mënyrë:

1. Znj. Esmeralda Qirko zotëron 25% të kuotave në kapitalin themeltar të Shoqërisë ose 25.000 lekë;
2. Z. Vito Loparco zotëron 50% të kuotave në kapitalin themeltar të Shoqërisë ose 50.000 lekë;
3. Z. Maksim Çuedari zotëron 25% të kuotave në kapitalin themeltar të Shoqërisë ose 25.000 lekë.

Me vendimin e datës 14.01.2005 të Asamblesë së Ortakëve të kësaj shoqërie, është vendosur miratimi i shitjes së kuotave, në masën 50% të kuotave që zotëron ortaku i Shoqërisë, Z. Vito Loparco në favor të blerësve, ortakëve të tjerë të shoqërisë Znj. Esmeralda Qirko dhe Z. Maksim Çuedari, ku secili përfiton nga 25% të kuotave që shiten secili.

Shitia e 50% të kuotave nga ortaku i Shoqërisë Tregtare "BERAT konfeks" sh.p.k., sjell humbjen e së drejtës së pronësisë të kuotave mbi pjesën e shitur, si pasojë e këtij transaksiioni shitjeje, shprehur kjo në vendimin e Asamblesë të Ortakëve të datës 14.01.2005.

Shitësi, ortaku Z. Vito Loparco është plotësish dakort të shesë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, kuotat që ai zotëron në kapitalin themeltar të shoqërisë në tërësinë e tyre me vlerë 50% të kapitalit themeltar në favor të blerësve.

Nga ana e tij Blerësit, ortakët Znj. Esmeralda Qirko dhe Z. Maksim Çuedari janë plotësish dakort që të blejnë secili nga 25% të kuotave që shiten dhe në total 50% të kuotave që zotëron Shitësi në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare "BERAT konfeks" sh.p.k., duke fituar në këtë mënyrë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kalimi i pronësisë së këtyre kuotave dhe duke rritur përqindjen që ata zoterojnë në kapitalin e shoqërisë përkatësisht në mësën 50% secili.

MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

Me nënshkrimin e kësaj kontrate Shitësi, ortaku Z. Vito Loparco e humbet pronësinë e tij në masën 50% të kuotave që ai zotëron në kapitalin themeltar të shoqërisë "BERAT konfeks" sh.p.k., duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi këtë pjesë. Ndërsa Blerësit, ortakët Znj. Esmeralda Qirko dhe Z. Maksim Çuedari, bëhen pronar edhe të 50% të kuotave që shiten në masën 25% secili duke zotëruar secili ortak pas shitjes nga 50% të kuotave të kapitalit themeltar.

Shoqëria Tregtare "BERAT konfeks" sh.p.k., pas realizimit të kësaj kontrate shit – blerje do të ketë si ortak të saj, me pjesëmarrje si më poshtë:

- Znj. Esmeralda Qirko zotëron 50 kuota ose 50% të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë të barabarta me vlerën 50.000 lekë.
- Z. Maksim Çuedari zotëron 50kuota ose 50% të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë të barabarta me vlerën 50.000 lekë.

ÇMIMI I SHITJES SË KUOTAVE

Si çmimi i këtij transaksioni shit – blerje të aksioneve të shoqërisë tregtare “BERAT konfeks” s.p.k. do të jetë 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, çmim i cili bazohet në vlerën nominale të një kuote prej 1000 lekë, sipas përcaktimeve të nenit 6 të Statutit të shoqërisë.

Blerësit, Znj. Esmeralda Qirko dhe Z. Maksim Çuedari paguajnë në favor të Shitësit Z. Vito Loparco, shumën totale prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, shumë e cila është paguar jashtë kësaj zyre dhe shitësi nuk do të ketë sot dhe në të ardhmen pretendime përkëtë shumë apo për çdo shumë tjetër.

DISPOZITA TË FUNDIT

Kontrata hartohet në gjashtë kopje të njëjta, nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje depozitohet në Zyrën e Regjistrat Tregtar, një kopje depozitohet në Aktet e Shoqërisë dhe një kopje pranë Zyrës së Noterisë ku ajo u redaktua.


Termat e kontratës, pasi u redaktuan prej meje Noterit, iu bënë të njobura palëve kontraktuese, të cilat e nënshkruan atë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, në prezencën time.

PALËT

SHITËSIT

Vito LOPARCO






BLERËSIT

Maksim ÇUEDARI



Esmeralda QIRKO



NOTER

Agim ROBO



